

## **Partia Demokratike e Kosovës (PDK)**

### **Raportet financiare të fushatës dhe Raporti i Auditorëve të pavarur**

Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Podujevë  
03 Mars 2020 deri me 13 Mars 2020 dhe 23 Nëntor 2020 deri me 27 Nëntor 2020

**Përmbajtja:**

Raport i auditorëve të Pavarur.. .....	3
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	7
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	8
Informacionet e përgjithshme .....	9
Shënimet e pasqyrave financiare.....	10-12

# **Raport i Auditorëve te pavarur**

Drejtuar Kryesisë se Partisë Demokratike të Kosovës

## **Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike**

### **Opinion i pakualifikuar**

Ne kemi audituar raportet financiare të fushatës për zgjedhjet nacionale të bashkëngjitura të Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (në vijim referuar si “Subjekti Politik” apo “PDK”), të përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 27 Nëntor 2020, Pasqyra e të Hyrave dhe Shpenzimeve për periudhën 03 Mars 2020 deri me 13 Mars 2020 dhe 12 Nëntor 2020 deri me 27 Nëntor 2020, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira në faqe 7-12.

Sipas mendimit tonë, Pasqyrat Financiare të bashkëngjitura paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të subjektit Politik me 27 Nëntor 2020, dhe të hyrat dhe shpenzimet për periudhën 03 Mars 2020 deri me 13 Mars 2020 dhe 23 Nëntor 2020 deri me 27 Nëntor 2020, në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike dhe me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058

### **Bazat për Opinion të pa kualifikuar**

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në Përgjegjësitë e Auditorit në paragrafin për Auditimin e Pasqyrave Financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistet Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistet Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

### **Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre te ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare**

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitet sipas parimit të

vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë. Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

### **Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyes mërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit & Conto sh.p.k



Fatmir Mehmeti  
Auditor Ligjor  
6 Tetor 2021



**Partia Demokratike e Kosovës**

Pasqyrat Financiare të fushatës Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Podujevë

03 Mars 2020 deri me 13 Mars 2020 dhe 12 Nëntor 2020 deri me 27 Nëntor

**Pasqyra e Pozitës Financiare**

<b>Pasuritë</b>	<b>Shënimi</b>	<b>Bilanci në fund të periudhës</b>	<b>Bilanci në fillim të periudhës</b>
<b>Pasuritë afatgjata</b>			
Toka, objektet dhe pajisjet	5	0.00	
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë tjera afatgjata			
<b>Gjithsej pasuritë afatgjata</b>		<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Pasuritë afatshkurtra</b>			
Llogaritë e arkëtueshme	6	0.00	0.00
Parapagimet			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	7	0.00	0.00
Pasuritë tjera afatshkurtra			
<b>Gjithsej pasuritë afatshkurtra</b>		<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Gjithsej pasuritë</b>		<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Ekuiteti</b>			
Fondet e akumuluar		0.00	0.00
Suficiti / (deficiti) i vitit		(103.03)	0.00
<b>Gjithsej Ekuiteti</b>		<b>(103.03)</b>	<b>0.00</b>
<b>Detyrimet</b>			
<b>Detyrimet afatgjata</b>			
Huatë e pagueshme			
Të hyrat e shtyra		0.00	0.00
<b>Gjithsej detyrimet afatgjata</b>		<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	8	103.03	0.00
Huatë e pagueshme			
Detyrimet tjera afatshkurtra	9	0.00	0.00
<b>Gjithsej detyrimet afatshkurtra</b>		<b>103.03</b>	<b>0.00</b>
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>103.03</b>	<b>0.00</b>
<b>Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet</b>		<b>0.00</b>	<b>0.00</b>

**Partia Demokratike e Kosovës**Pasqyrat Financiare të fushatës Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Podujevë  
03 Mars 2020 deri me 13 Mars 2020 dhe 12 Nëntor 2020 deri me 27 Nëntor**Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve**

	Shënimi	03 Mars 2020 deri me 13 Mars 2020 dhe 12 Nëntor 2020 deri me 27 Nëntor 2020
<b>Të hyrat</b>		
Të hyrat nga buxheti		600.00
Të hyrat nga anëtarësia		
Donacionet dhe kontributet në të holla	3	
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime	4	5,380.00
Të hyrat tjera		
<b>Gjithsej të hyrat për vitin</b>		<b>5,980.00</b>
<b>Shpenzimet</b>		
Pagat dhe kompensimet		
Shpenzimet e transportit	2	
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	2	670.54
Blerja e mallrave		
Shpenzimet e përgjithshme	2	5,380.00
Shpenzimet e ndryshme		32.49
<b>Gjithsej shpenzimet për vitin</b>	2	<b>6,083.03</b>
<b>Suficiti / (deficiti) për vitin</b>		<b>(103.03)</b>

## **Partia Demokratike e Kosovës**

Pasqyrat Financiare të fushatës Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Podujevë  
03 Mars 2020 deri me 13 Mars 2020 dhe 12 Nëntor 2020 deri me 27 Nëntor 2020

---

### **1. Informata te përgjithshme**

#### **Partia Demokratike e Kosovës PDK**

Partia Demokratike e Kosovës është themeluar më datën 12.10.1999.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës për vitin 2020 është : z. Kadri Veseli

Sekretari i përgjithshëm : Z. Uran Ismaili

Zyrtar financiar : Muhamet Morina

Pasqyrat financiare te Partisë Demokratike te Kosovës janë përgatitur sipas kërkesave te Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar.

Bazuar në nenin 19 paragrafi 2 pika 7 e Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 ,Subjekti i regjistruar politik brenda pesë (5) ditëve të punës nga marrja e draft raporteve të audituara ka dorëzuar raportin e rishikuar financiar dhe shpjegimet lidhur me gabimet ose lëshimet të identifikuar nga auditorët.

Subjekti Politik mirëmban llogari kryesore bankare ne bankën NLB

**Partia Demokratike e Kosovës**

Pasqyrat Financiare të fushatës Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Podujevë

03 Mars 2020 deri me 13 Mars 2020 dhe 12 Nëntor 2020 deri me 27 Nëntor 2020

**Shënimi 2: Shpenzimet**

Shpenzimet	Shpenzimi në Euro	Pagesa në Euro	Borxhi i mbetur në Euro
<b>Pagat dhe kompensimet</b>			
Pagat dhe kompensimet, neto			
Pagesat e vëzhguesve			
Kontributet pensionale të punëmarrësit			
Kontributet pensionale të punëdhënësit			
Tatimet në të ardhura personale			
Beneficionet tjera			
<b>Gjithsej</b>			
<b>Shpenzimet e transportit</b>			
Automjetet motorike të huazuara			
Karburantet			
Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksitë etj.			
Sigurimi dhe mirëmbajtja e veturave			
Çdo shpenzim tjetër i transportit			
<b>Gjithsej shpenzimet e transportit</b>			
<b>Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat</b>			
Lokali			
Ushqimi	670.54	600.00	70.54
Aktivitete kulturore dhe rekreative			
Radio dhe spotet televizive			
Stendat e afishimit dhe reklamimet në gazeta			
Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave			
<b>Gjithsej reklammat, reprezentacioni dhe konferencat</b>	<b>670.54</b>	<b>600.00</b>	<b>70.54</b>
<b>Blerja e mallrave</b>			
Furnizimi i zyrës			
Pajisjet të vogla			
<b>Gjithsej blerja e mallrave</b>			
<b>Shpenzimet e përgjithshme</b>			
Qiraja e lokalit të zyrës			
Telefoni, interneti dhe posta			
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)			
Gjoha dhe ndëshkime			
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet ne natyrë në mallra dhe shërbime	5,380.00	////////////////////////////////////	
<b>Gjithsej shpenzimet e përgjithshme</b>	<b>5,380.00</b>		
<b>Shpenzimet e ndryshme</b>			
Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës	32.49	0.00	32.49
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër			
<b>Gjithsej shpenzimet e ndryshme</b>	<b>32.49</b>		<b>32.49</b>
<b>Gjithsej shpenzimet</b>	<b>6,083.03</b>	<b>600.00</b>	<b>103.03</b>



**Partia Demokratike e Kosovës**

Pasqyrat Financiare të fushatës Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Podujevë  
03 Mars 2020 deri me 13 Mars 2020 dhe 12 Nëntor 2020 deri me 27 Nëntor 2020

**Shënimi 3: Donacionet dhe kontributet në të holla**

Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera në euro	E pranuar përmes:	
Kontribuesi	Adresa	Numri personal			Bankë	Arkë
Gjithsej donacionet dhe kontributet në të holla					////////	

**Shënimi 4: Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime**

Përshkrimi i mallit / shërbimit	Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera në euro
	Kontribuesi	Adresa	Numri personal		
Kontribut Vullnetar	Vëzhguesit	Podujevë	Regjistri	03/03/2020 dhe 27/11/2020	5,380.00
Gjithsej kontributet në natyrë në mall dhe shërbime					5,380.00

**Shënimi 5: Toka, objektet dhe pajisjet**

Për periudhën: 12 Nëntor 2020 deri me 27 Nëntor 2020

	Blerjet gjatë periudhës
Toka	
Objektet	
Veturat	
Pajisjet e zyrës	
Pajisjet e teknologjisë informative	
Pajisjet tjera	
Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet	////////////////////////////////////

**Partia Demokratike e Kosovës**Pasqyrat Financiare të fushatës Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Podujevë  
03 Mars 2020 deri me 13 Mars 2020 dhe 12 Nëntor 2020 deri me 27 Nëntor 2020**Shënime tjera**

<b>Shënimi 6. Llogaritë e arkëtueshme</b>	<b>Bilanci në fund të periudhës Shuma në Euro</b>	<b>Bilanci në fillim të periudhës Shuma në Euro</b>
..... blerësi 1		
..... blerësi 2		
..... blerësi 3		
..... blerësi 4		
Llogari të arkëtueshme të tjera		
<b>Gjithsej llogaritë e arkëtueshme</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>

<b>Shënimi 7. Paraja dhe ekuivalentët e parasë</b>	<b>Bilanci në fund të periudhës Shuma në Euro</b>	<b>Bilanci në fillim të periudhës Shuma në Euro</b>
Paraja në bankë		
Paraja në arkë		
<b>Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>

<b>Shënimi 8. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera</b>	<b>Bilanci në fund të periudhës Shuma në Euro</b>	<b>Bilanci në fillim të periudhës Shuma në Euro</b>
Max Hipermarket	103.03	
..... furnitori 2		
..... furnitori 3		
..... furnitori 4		
Llogari të pagueshme të tjera		
<b>Gjithsej llogaritë e pagueshme dhe të tjera</b>	<b>103.03</b>	<b>0.00</b>

<b>Shënimi 9. Detyrimet tjera afatshkurtra</b>	<b>Bilanci në fund të periudhës Shuma në Euro</b>	<b>Bilanci në fillim të periudhës Shuma në Euro</b>
Detyrimet për paga dhe tatime		
Detyrimet për qira		
Detyrimet për gjoba dhe ndëshkime		
Detyrimet tjera afatshkurtra		
<b>Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>

